



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 835/10 Prot.

Durrës, më 04.02.2026

**V E N D I M**

Nr. 17, Datë 04.02.2026

**P Ë R**

**"MIRATIMIN PARAPRAK PËR SHPËRBLIMIN E STAFIT TË ANGAZHUAR  
GJATË EMERGJENCËS SË KRIJUAR NGA PËRMBYTJET E DATËS 06.01.2026  
NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në Urdhërin e Rektorit nr. 7, datë 06.01.2026, në relacionin nr. 26/1 prot., datë 14.01.2026 të grupit të punës, si dhe në propozimin e grupit të punës me shkresë nr. 26/2 prot., datë 04.02.2026, në mbledhjen e datës 04.02.2026, Senati Akademik,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin paraparak për shpërblimin e stafit i cili është angazhuar dhe ka kontribuar përtej orarit të punës gjatë emergjencës së krijuar nga përmbytjet e datës 06.01.2026, si dhe për normalizimin e situatës së krijuar në Kampusin Universitar "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Propozohet shpërblimi për stafin e cituar në relacionin nr. 26/1 prot., datë 14.01.2026, në masën 20.000 lekë për secilin.
3. Ky vendim i kalon për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

**K R Y E T A R**

**Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi**

